

## Fletë informuese 6:

HEC Peshku konflikt mbi pronësinë me banorët.

<b>Përshkrim</b>	Kompania Koka shpk, nisi procedurat për ndërtimin e HEC Peshk-ut që në vitin 2003 dhe në vitin 2007, përzgjedhi si partner Shijaku shpk për të vazhduar bashkërisht investimin për ndërtimin e hidrocentralit. HEC Peshku u ndërtua në pjesën veriore të Shqipërisë, në jug të fshatit Krastë, ndërmjet fshatrave Peshk dhe Gjon. Megjithatë në 15 shkurt 2016, gjatë dëshmisë së K.P, lidhur me aktivitetet e një grupimi kriminal, u zbulua një urdhër për vrasje, gjoja e porositur nga administratori i kompanisë së hidrocentralit lidhur me Koka shpk. Porosia në fjalë, kishte lidhje me konfliktin që ekzistonte për pronësinë e tokës ku ishte ndërtuar hidrocentrali, me një banor vendas. Referuar dhe burimeve në media, dëshmia u verifikua nga një kallëzim i depozituar në vitin 2010 nga pronari i tokës, ku akuzonte të njëjtin person të së njëjtës kompani. <sup>20</sup>
<b>Të dhëna kryesore</b>	<b>Koka &amp;Ergi Energy Peshku” shpk</b> Projekti është 3.6 MW dhe prodhimi vjetor është 17.95 Gwh. Projekti prodhon energji, duke shfrytëzuar ujin e lumit Mat ndërmjet kuotave 709 m dhe 590 m me një devijim prej 2.2 km, që kalon në anën e djathtë të lumit. Vepra e marrjes së ujit është vendosur mbi urën e fshatit Peshk, në pikën ku dy degët e Përroit Lena dhe Përroit Thekna takohen për të formuar lumin Mat. Godina e hidrocentralit, është ndërtuar në krahun e djathtë të lumit përballë pikës ku Përroi Xixull takohet me lumin Mat. Projekti do të shfrytëzohet 185 ditë gjatë kohës së thatë dhe 236 ditë gjatë kohës së lagësht.
<b>Burimi i konfliktit</b>	Konflikt i pronës – niveli i 1-rë i konfliktit  Menaxhim i ujit - niveli i 2-të i konfliktit  Devijim i ujit – niveli i 3-të i konfliktit
<b>Detaje të projektit dhe aktorët</b> <b>Zona e projektit</b> <b>Niveli i investimit</b>	HEC Peshku është në pronësi të Koka shpk e 51% dhe Shijaku shpk me 49%.  Investimi i projektit është rreth 5,500,000 euro. “Koka &Ergi Energy Peshk” shpk, është regjistruar në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit më datë 27.06.2008 me NIPT K88027901B.
<b>Konflikti dhe mobilizimi</b>	Tentative vrasje i pronarit të tokës.
<b>Ndikimi i konfliktit</b>	<b>Potencial</b> Ndikimi mjedisor – S’ka të dhëna  <b>Potencial</b> Ndikimi socio-ekonomik: çështje pronash
<b>Rezultati i konfliktit</b>	Ndërtuar Asnjë ndryshim institucional Në prodhim që prej 2012
<b>Burimet dhe materialet/Referencat</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- NIPT K88027901B - Ekstrakt historik nga QKR;</li> <li>- <a href="http://www.mapo.al/2016/02/biznesmeni-50-mije-euro-per-vrasjen-e-nje-pronari-tokash/1">http://www.mapo.al/2016/02/biznesmeni-50-mije-euro-per-vrasjen-e-nje-pronari-tokash/1</a></li> <li>- <a href="http://koka-shpk.com/web/energjitike/h-peshk/">http://koka-shpk.com/web/energjitike/h-peshk/</a></li> </ul>

<sup>20</sup> Eksperti nuk gjeti ndonjë të dhënë dhe nuk ishte në pozicion për të bërë verifikime për raportimin e medias për shkak të profilit të rastit konfliktual. Arsyja e prezantimit të rastit lidhet me rëndësinë e përmendjes së llojit të konfliktit i lidhur me hidrocentralet dhe pronësinë në përgjithësi.